



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:135328
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05751066

AC.nr.6533/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj, antarë të kolegjit, në kontestin e paditësve: V. K., N. K., M. K. dhe . K. nga fshati R., K-D dhe M. O. nga D. Komuna e D. të cilin e përfaqëson Avokat B. M. nga P. me autorizim kundër të paditurës B. K. e S. (BKS) në P., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi më autorizim M.P. nga P. për kompensim demi nga baza e auto-përgjegjesisë, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e paditura B. K. e S.-BKS me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 258/16, të datës 31.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

IAPROVOHET Pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës B. K. e S.-BKS me seli në P., ashtu që: **NDRYSHOHET Pjesërisht** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.258/16, i datës 23.09.2019, sa i përket pikës **III** të dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës, si dhe Aktvendimi për përimirësimin e aktgjykimit me numër C.nr.258/16, i datës 31.10.2019, lidhur me shpenzimet e procedurës, ashtu që, lidhur me këtë pikë, gjykohet si në vijim:

II.DETYROHET e paditura B. K. e S.-BKS me seli në P., që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve V. K. etj të gjithë nga fshati R./Komuna e D., t'ua paguaj shumën totale prej **4,568 euro**, dhe atë, në emër të përpilimit të padisë shumën prej **624 euro**, në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej **50 euro**, në emër të shpenzimeve të ekspertiza mjekësore dhe financiare shumën totale prej **650 euro**, për 4 seanca gjyqësore të përfaqësuara nga i autorizuari i paditësve shumën totale prej **3,244.80 euro** (për secilën seancë gjyqësore shumën nga **811.20 euro**).

III.Pjesa tjetër e ankesës së të paditurës B.K. e S.-BKS me seli në P., sa i përket pikës **I** dhe **II** të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.258/16, i datës 23.09.2019, **REFUZOHET SI E PA BAZUAR**, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.258/16, i datës 23.09.2019, në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

IV.Pika **IV** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.258/16, i datës 23.09.2019, **ngel e pa shqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan- Departamenti i përgjithshëm me aktgjykimin C.nr. 258/16, të datës 23.09.2019, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET- pjesërisht si e bazuar, kërkes padia e paditësve V. K. N. K., M. K. dhe L.K. të gjitha nga fshati R., K-D. dhe M. O. nga K- D. të cilat më autorizim i përfaqëson Avokat B. M. nga P.

II.DETYROHET-e paditura B. K. e S. me seli në P., që paditësve V. K. N. K., M. K. dhe L. K. të gjitha nga fshati R., K-D. dhe M. O. nga K- D. për aksidentin e ndodhur me date 26.07.2015, në fshatin C. K-D. te ja paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

Për paditsen V. K.në emer të demit jo material

Zhdentim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej—1700 euro
Zhdentim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej -----1500 euro
Zhdentim për dhimbje shpirtërore për shëmtim shumën prej-----2500 euro

Për demin material

Shpenzime për ushqim të përforëcur shumën prej-----200 euro
Shpenzime për kujdes dhe ndihmë të huaj në shumën prej-----200 euro
Në shum të përgjithshem prej -----6100 euro

Për paditsen N. K.në emer të demit jo material

Zhdentim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej-----1500 euro
Zhdentim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej-----1500 euro
Zhdentim për zvoglimin të aktivitetit të përhershëm jetësor shumën prej----- 1500 euro

Për demin material

Shpenzime për ushqim të përforëcur shumën prej-----100 euro
Shpenzime për kujdes dhe ndihmë të huaj në shumën prej-----100 euro
Në shum të përgjithshem prej -----4700 euro

Për paditsen M. K.në emer të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej---1500 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej-----1500 euro
Në shum të përgjithshëm prej -----3000 euro

Për paditsen L. K. në emër të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej----2500 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej-----1000 euro
Në shum të përgjithshëm prej -----3500 euro

Për paditsen M. O. në emër të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej---1500 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej-----1500 euro
Zhdëmtim për zvogëlimin të aktivitetit të përhershëm jetësor shumën prej-----1500 euro

Për demin material

Shpenzime për ushqim të përforëcur shumën prej -----100 euro
Në shum të përgjithshëm prej -----4600 euro

Për demin material për shkak të aksidentit të komunikacionit të paditësve sipas fakturave për shpenzimet e mjekimit të paditësve të konvertimit nga Kruna Nervogjeze prej 52.292.55 bazuar sipas ekspertizës të ekspertit Finaciari Gani Gashi për vitet: 2015-2016-2017 dhe 2018 sipas tabelës numër 1 dhe 2 të ekspertizës që gjenden në shkresat e lëndës në shumën prej 5.663.68 euro në kushte normale.

E paditura B. K. e S.(BKS) me seli në P. , që shumat e gjykuara si në pikën **II**, në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ti paguaj me kamatë sipas norms prej 8% në vitë, nga dita e publikimit të aktgjykimit më datë 04.10.2019, e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

III.DETYROHET e paditura që paditësve të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore prej prej 3.135.80 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

IV.Refuzohet kërkespada e paditësve V. K. N. K., M. K.dhe L. K. të gjitha nga fshati R., K-D. dhe M. O.nga K- D. që të detyrohet e paditura B. K. e S. me seli në P., dhe atë:

Për paditsen V. K. në emër të demit jo material:

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej—1800euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej -----1000 euro
Zhdëmtim për dhimbje shpirtërore për shëmtim shumën prej-----2500 euro

Për demin material

Shpenzime për ushqim të përforëcur shumën prej-----250 euro
Shpenzime për kujdes dhe ndihmë të huaj në shumën prej-----250 euro
Shpenzimet për terapi fizikale Shumen prej -----800 euro

Për paditsen N. K. në emer të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumë prej-----1500 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumë prej-----1000 euro
Zhdëmtim për zvoglimin të aktivitetit të përhershëm jetësor shumë prej----- 1500 euro

Për paditsen M. K. në emer të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumë prej---1000 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumë prej-----500 euro

Për paditsen M.O. në emer të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumë prej---1500 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumë prej-----1000 euro
Zhdëmtim për zvoglimin të aktivitetit të përhershëm jetësor shumë prej-----1500 euro

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë e paditura B. K. e S. BKS me seli në P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim nga pala paditëse që të aprovohet ankesa e të njëjtit dhe aktgjykimi i ankimuar në pikën I dhe II të dispozitivit të tij (pjesën aprovuese të kërkesëpadisë), me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që të aprovohet ankesa dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda të kthehet në ri gjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësit nuk kanë ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë ankimore, pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve ankimore, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe e) në lidhje me nenin 200, në lidhje me nenin 208 dhe 209 pika c) të LPK-së, konstatoi se:

Ankesa e e të paditurës B. K. e S.-BKS me seli në P. rezulton pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit V., M., N. dhe L. K. të gjithë nga fshati R./Komuna e D., me datën 02.12.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 26.07.2016, dhe me precizimin e kërkesëpadisë, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që në emër të shpërbimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të shkaktuar me datën 16.03.2017 në Gjakovë, paditësit t'ia paguajë shumë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me kamatë ligjore prej 8% vjetore si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seancat e shqyrtimeve gjyqësore në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pjesërisht e konteston padin e padises për nga baza pasi që në procedur administrative kemi trajtuar kete qeshtje dhe pjesërisht kemi dhen ofetren për disa

paditsemegenëse nga mjekët censor të BKS –ës nuk kemi marr një konfirmim të shkruar rreth vlerësimit të faktuarve-shpenzimeve të shërimit rreth lidhjes kauzale ne mund të ofrojmë ofertë për: V. K.4500 euro, N.K. 4000 euro, M.K. 1200 euro, L. K. 1200 euro dhe M. O. 4000 euro, konsiderojmë që kjo ofertë është reale dhe harmoni me natyrën e lëndimeve me referencës ekspertizën e dt. 27.07.2018 ndërsa sa i përket shpenzimeve të shërimit për të njëjtat nuk mund të deklarohem dhe do të deklarohem nëse nga mjekët censor do të marr një vlerësim të shkruar rreth shpenzimeve të shërimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas nxjerrjes dhe administrimit të provave, mbajtjes së seancave gjyqësore, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të analizimit të detale të provave dhe në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se shoferi I veturës A i markës BMË 335 me traga xxx është shkaktar I këtij aksidneti me lëshimet e tij.

Mos mbajtja e anës se djathtë e rrugës gjatë përballë kalimit me veturën B dhe dalja në anën e kundër të rrugës duke shkaktuar goditjen me veturën B me dëme material dhe lëndime trupore . Ngasja me shpejtësi të pa përshtatur dhe të pa sigurt kushteve të gjeoemtrisë të rrugës e cila ishte kthesë në të majtë dhe kushteve të gjendjes monetale të shtresës se rrugës e cila ishte e lagur me cilin rast nuk mund ta përballoj kthesën por duke u sjellur del në anën e amjtë të rrugës duke e goditur veturën B të markës Rango Rover. Te ciles ekspertize te lartshenuar te kyer ne menyre profesionale nga eksperti Blendi Parashunti gjykata ja ka falur besimin dhe me ane te ciles ekspertize te komunikacionit vertetohet edhe baza juridike e kerkespadis.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për ti kompensuar paditësit gjenë mbështetje në dispozitat e nenit 136,140 dhe 159.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore. Sipas dispozitave të nenit 136 të LMD-së, parashihet se kush I shkaktontjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, në qoftë se nuk provon se demi ka lindur pa fajin e tij, ndërsa me dispoziten e nenit 140, parashihet se fajsia ekzistin kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispoziten e nenit 159, parashihet se ‘në rast aksidenti të shkaktura nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faji të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësin në bazë të fajsisë’.

Eksperti Nazmi Morina- Ortopedis nga Spitali Regjional në Pejë për paditësen V.K. gjate seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ka pësuar aksident komunikacioni si bashkëudhëtare me datë 26.07.2015 e si rast urgjen është dërguar në Emergjencën e Spitalit të Pejës, numër 13/387 ora 17:50min, ku është ekzaminuar, janë bërë fotografimet e nevojshme, është imoblizuar dhe është lëshuar për trajtim të mëtejme në vendin ku jeton. Kemi edhe raporte specialistike të lëshuara disa muaj më vonë nga shteti i Norvegjisë, ku së pari me 29.07.2015 është pranuar në spital universitar dhe është operuar, raporte specialistike nga ana e ftiziatrit ku konfirmohet tretmani i gjatë post-operativ dhe raporti specialistike të këtij viti ku shihet ecuria post- traumatike, post- operative dhe post- fiziatrike.

Në bazë të kësaj konkludojmë që V. K., pësoi këto lëndime: frakturë e humerusit të djathtë, Ndrydhje koke, qafe, trupi dhe ekstremitete.

Në lëndimet e përshkruara duhet të ceket lëndimi intra- operativ neuropraksia e nervit radial, e cila është e evidentuar në fletëlëshim të Spitalit të Norvegjisë dhe është pranuar nga mjeku

ordinues që është lëndim intra operativ e që në fjalët tona është ndrydhje dhe zgjatje e nervit radial gjatë operacionit.

Në bazë të kësaj konkludojmë që V. K.ka pësuar lëndime të rënda trupore pa invaliditet të përhershëm

- Dhembje të intensitetit tejet të lartë ishin në kohëzgjatje 2-3 minuta,
- Dhembje të intensitetit të lartë ishin në kohëzgjatje prej 4 orë, çka i referohet kohës së transportit të pacientes në lokalet e emergjencës, ndikimit të terapisë, ekzaminimeve të bëra dhe imobilizimi.
- Dhembje të intensitetit të mesëm ishin në kohëzgjatje prej tetë javë ku përfshihen: dhimbjet gjatë udhëtimit për në Norvegji, dhimbjet post- operative, dhimbjet gjatë tretmanëve të gjata fiziatrike.
- Dhimbje të intensitetit të ultë ishin në kohëzgjatje prej gjashtë muaj e që janë prezentë gjatë sforcimit të shtuar fizik, ndërrimit të kohës, gjendjeve të ndryshme psikike etj.
- Ndihma e personit të huaj, ishte e nevojshme në kohëzgjatje prej tre muaj, ushqimi i përforcuar me proteina, karbohidrate dhe vitamina ishte i nevojshëm prej tre muaj, çka ju desh humerusit të operuar të operohet. Nevoja për terapi fizikale që e nevojshme tre herë nga 15 ditë në dy vitet e para e çka i referohet problemit të lëndimit të nervit dhe kontrakturës përcjellëse të brrylit pas operacionit të humerusit. Shëmtimi është i shkallës së mesme.

Eksperti Psikatri Muhamet Halitaj-nga spitali Regjional në Peje për paditësen V. K. gjatë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se konstatojm se ka përjetuar:

- Frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhë është e përcjellur me një shtangim afektiv,
- Frikë sekondare me intensitet të lartë ka pasur në periudhën kohore deri në tri orë, duke llogaritur kohën nga momenti i aksidentit, dërgimi i saj në QKMF në Derçan dhe pastaj në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë ku i janë bërë ekzaminimet dhe rehabilitimi mjekësor. Kjo periudhë është përcjella me të rrahura të shpejtuara të zemrës, frymëmarrje të vështirësuar, dridhje të muskujve dhe ankesa tjera trupore.
- Frikë sekondare me intensitet të mesëm ka pasur deri në tre muaj, të manifestuar me një çrregullim të stabilitetit psiko- fizik, si pasojë e aksidentit, si: pengesa të herë pas hershme në gjumë, rikujtim të ngjarjes traumatike, ankth të gjeneralizuar, shkallë më të ultë të tolerancës prostatave, kufizim të pjesërishëm të aktiviteteve jetësore dhe ankesa të tjera trupore.
- Frikë sekondare me intensitet të ultë ka pasur në periudhën kohore deri në gjashtë muaj e që është manifestuar gjatë kohës kur ka dalur në komunikacion, apo ngjarje që ia rikujtojnë aksidentin.

Eksperti Nazmi Morina- Ortoped për paditësen N. K.,gjateë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar si pasoj aksident komunikacioni me datë 26.07.2015, ku si rast urgjent, u dërgua në Emergjencën e Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, ku bëhen ekzaminimet e nevojshme dhe pranohet në repartin Kirurgjik dhe qëndron prej datës 26.07.2015-29.07.2015 dhe pësoi këto lëndime:

- Tronditje truri,
- Ndrydhje koke, qafe dhe trupi,
- Marramendje,
- Vjellje,

Në bazë të kësaj konkludojmë që N. K. pësoi lëndim të rëndë trupor me invaliditet të përhershëm 3% bazuar në normat e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë Kapitulli I, pika 121.

- dhimbje të intensitetit tejet të lartë nuk pati,
- dhimbje të intensitetit të mesëm tre javë,
- dhimbje të intensitetit të ultë tre muaj, këtë e vërtetoi me raportin Specialistik të sjellë nga shteti i Norvegjisë ku shihet se edhe tre muaj më vonë ishte ende në tretman fiziatrik.
- Ushqimi i përforcuar ishte i nevojshëm në kohëzgjatje prej dy jave, ndihma e personit të huaj ishte e nevojshme në kohëzgjatje prej dy jave, shëmtim nuk ka, terapi fizikale që e nevojshme në kohëzgjatje 2 herë nga 15 ditë në vitin e parë.

Eksperti Muhamet Halitaj- psikiatër për paditësen N. K., gjateë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se

- Ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo është periudha nga momenti që ka bërë përpjekje ti shmangët aksidentit deri në humbjen e vetëdijes.
- Frikë sekondare me intensitet të lartë ka pasur pas vetëdijesimit në kohëzgjatje prej tri ore, të manifestuar me mundim, të rrahura të shpejtuara të zemrës, djersitje, frymëmarrje të vështirësuar dhe ankesa tjera trupore.
- Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka pasur në periudhën kohore deri në katër muaj të manifestuar me një çrregullim afektiv afatgjatë si pasojë e aksidentit, si: indisponim, pengesa të herë pas hershme në gjumë, rikujtim i ngjarjes traumatike, ankth të gjeneralizuar, fobi specifike nga veturave si dhe ankesa tjera trupore.
- Frikë sekondare me intensitet të ultë ka pasur në periudhën kohore deri në gjashtë muaj, e që është manifestuar gjatë kohës kur ka udhëtuar apo ngjarje që ia rikujtojnë aksidentin.

Eksperti i Ortopedisë Nazmi Morina, për paditësen M. K., gjateë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar si pësoi aksident komunikacioni si bashkëudhëtare dhe është dërguar në emergjencën e Deçanit për ekzaminim ku janë konstatuar këto diagnoza:

-Ndrydhje koke, trupi dhe qafe, dhe është lëshuar në shtëpi me terapi analgjetike.

Në bazë të kësaj, anamnezës të marrë në lokalet e gjykatës dhe ekzaminimit konkludojmë që M. K. ka pësuar lëndime të lehta trupore.

- Dhimbje të intensitetit tejet të lartë nuk pati,
- Dhimbje të intensitetit të lartë i përjetoi në kohëzgjatje prej një ore (për shkak të gjendjes shokante stresuese ajo këto dhimbje i neglizhoi),
- dhimbje të intensitetit të mesëm ishin në kohëzgjatje prej tri jave,
- dhimbje të intensitetit të ultë në kohëzgjatje prej katër jave.
- Ushqimi i përforcuar nuk që i nevojshëm, ndihma e personit të huaj nuk që e nevojshme, shëmtim nuk ka, terapi fizikale nuk që e nevojshme.

Eksperti Muhamet Halitaj- Psikiatër për paditësen M. K. gjateë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar si pasojë e aksidentit ka përjetuar:

- Frikë primare të intensitetit të lartë prej disa sekondave, kjo periudhë është përcjellë me një shtangim afektiv,
- Frikë sekondare në intensitet të lartë ka pasur në periudhën kohore deri në një ore, të manifestuar me mundim, të rrahura të shpejtuara të zemrës dhe ankesa tjera somatike.
- Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka pasur në periudhën kohore deri në dy javë të manifestuar me një çrregullim të stabilitetit psiko- fizik si pasojë e aksidentit si: pengesa

të herë pas hershme në gjumë, rikujtim të ngjarjes traumatike, shkallë më të ultë të tolerancës prostatave dhe ankesa të tjera trupore.

- Frikë sekondare me intensitet të ultë ka pasur në periudhën kohore deri në gjashtë javë e që është manifestuar gjatë kohës kur ka dalë në komunikacion apo ngjarje që ia rikujtojnë aksidentin.

Eksperti i Ortopedisë Nazmi Morina për paditësen . K.gjateë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se si pësoi aksident komunikacioni me datë 26.07.2015, si bashkudhëtarë. Dhe si rast urgjent dërgohet në emergjencën e Deçanit ku ekzaminohet dhe lëshohet në shtëpi me këto diagnoza:

- Ndrydhje koke, qafe dhe trupi,
- Ndrydhje të regjionit të hundës.
- Epistaksis (gjakderdhje nga hunda).

Nga kjo konkludojmë që L.K. pësoi lëndime të lehta trupore.

- Dhimbje të intensitetit të lartë ishin në kohëzgjatje prej një minuti,
- Dhimbje të intensitetit të lartë ishin në kohëzgjatje prej një ore,
- Dhimbje të intensitetit të mesëm dy javë,
- Dhimbje të intensitetit të ultë katër javë.
- Ushqimi i përforcuar nuk qe i nevojshëm, shëmtim nuk ka, terapi fizikale nuk qe e nevojshme, ndihma e personit të huaj nuk qe e nevojshme.

Eksperti Muhamet Halitaj- Psikiatër për paditësen L. K. gjatë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se meqenëse ka qenë nën moshën 5 vjeçare ka përjetuar:

- Frikë sekondare të intensitetit të lartë por nuk mund të definohet kohëzgjatja për shkak të moshës së saj.

Eksperti i Ortopedisë Nazmi Morina për paditësen M. O., gjateë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar si pësoi aksident komunikacioni me datë 26.07.2015, ku pësoi si bashkudhëtarë, dhe si rast urgjent është dërguar në Emergjencën e Spitalit të Pejës nr. 13/384, ku pas ekzaminimeve të bëra është pranuar në repartin Kirurgjik dhe ka qëndruar deri me datë 30.07.2015, nr. amë i historisë 68/45, nga dokumentacioni i prezantuar dhe nga ekzaminimi i bërë në lokalet e gjykatës, konkludojmë që pësoi:

- tronditje truri,
- ndrydhje koke, qafe dhe trupi,
- Ndrydhje të regjionit të gjoksit në anën e majtë,

Këto lëndime klasifikohen si lëndime të rënda trupore e që është 3% sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, Kapitulli I pika 121.

- Dhimbje të intensitetit tejet të lartë nuk i përjetoi,

- dhimbje të intensitetit të lartë ishin në kohëzgjatje prej dy ore çka i referohet kohës së vetëdijesimit, ndikimit të terapisë.
- Dhimbje të intensitetit të mesëm ishin në kohëzgjatje prej gjashtë jave çka i referohet dhimbjeve të regjionit të gjoksit, të regjioni i të cilave është i lidhur ngushtë me frymëmarrje,
- Dhimbje të intensitetit të ultë ishin në kohëzgjatje prej tre muaj që gjithashtu interferojnë me dhimbje të toraksit- gjoksit.
- Ndhurma e personit të huaj nuk qe e nevojshme, ushqimi i përforcuar qe i nevojshëm në kohëzgjatje prej dy jave, shëmtim nuk ka, terapi fizikale nuk pati nevojë.

Eksperti Muhamet Halitaj- Psikiatër, për paditësen M. O., gjatë seancës të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ka përjetuar:

- Frikë primare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhë është përcjellur me një shtangim afektiv,
- Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka pasur në kohëzgjatje prej dy ore të manifestuar me të rrahura të shpejtuara të zemrës, frymëmarrje të vështirësuar, dridhje të muskujve dhe ankesa tjera trupore,
- Frikë sekondare me intensitet të mesëm ka pasur në periudhën kohore deri në gjashtë javë, të manifestuar me një çrregullim të stabilitetit psiko- fizik si pasojë e aksidentit të manifestuar me indisponim, pengesa në gjumë, ankth të gjeneralizuar, shkallë më të ultë të tolerancës frustrative dhe ankesa të tjera trupore,
- Frikë sekondare me intensitet të ultë ka pasur në periudhën kohore deri në katër muaj e që është manifestuar gjatë kohës kur ka dalë në komunikacion apo ngjarje që ia rikujtojnë aksidentin.

Prandaj bazuar në faktin se e paditura është përgjegjëse për demin të cilës paditësve i kanë shkaktuar gjatë aksidentit të komunikacionit, gjykata e detyroj të paditurën që paditësve tija paguan në emër të dëmit material dhe jo material shumë si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimit. Me rastin e përcaktimit të lartësisë se dëmit gjykata pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, si intensitetin e dhembjeve fizike, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shëmtimin, frikën e përjetuar paditëses në aksident kohëzgjatjen e saj, duke gjetur se shumë e caktuara për shpërblim të paditësve veç e veç do të ofrojnë satisfaksion të duhur për dhembjet e përjetuara, dhe se do të ndikojnë në vënien e baraspeshës psikike dhe emocionale të tyre. Në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësorë të përshkruar si me lart gjykata miratoj kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të demit si në pikën e lartshënuar të dispozitivit të këtij aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real objektiv dhe me bindje se ki shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit të paditësve.

Gjykata në tërësi i ka pranuar konstatimet e ekspertëve në fjalë, se të njejtat janë dhënë nga ana e ekspertëve përkatës dhe përputhen mes veti dhe dokumentacionin mjekësor që gjindet në shkresat e lëndës.

Pasi që Gjykat bëri vlersimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjithave së bashku e në lidhmëri njera me tjetrën e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në perfundim se në këtë çështje juridiko kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën e gjykuar ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 par. 2 të LPK-së.

Në mendimin e dhënë eksperti i ortopedisë Nazmi Morina dhe i psikiatrisë Muhamet Halitaj të lidhjes kauzale të fakturave për shpenzim të shërimit dhe aksidentit që ka ndodhur me dt. 27.06.2016. Kanë dhënë mendim se u përket fatuarve që janë prezent në shkresat e lëndës me numër të lëndës C.nr. 258/16 për V. K. të përkthyer në gjuhën Shqipe ushtrimet fizioterapeutike kanë lidhshmeri kauzale me lëndimet që kanë pësuar në aksident me dt. 26.07.2015 me përjashtim të fakturës me dt. 03.04.2017 ku ka marr trajtim nga Stomatologu,

ndërsa për N. K.përputhet lidhja kauzale në me mes traumës që ka pësuar në aksident dhe trajtimit mjekësor që ka pasur jashtë vendit.

Ekspeerti Finaciari i caktuar sipas propozimit të autorizuarit të paditësve Gani Gashi nga Peja në ekspertizën e tij të hartuar në gusht të vitit 2019 derguar gjykatës me shkrim që detyra e tij ka qenë konvertimi i faturave nga valuta e krunave nervogjeze në valutën euro sipas faturave të paraqitura në shkresat e lëndës.

Në mendimin dhe konstatimin etij në ekspertizë për dëmin material të pësuar për shkak të aksidentit të komunikacionit të paditësve sipas faturave për shpenzimet e paraqitura për konvertim nga paditësit për vitet 2015-2016-2017 dhe 2018 sipas tabelës numër 1 dhe 2 të ekspertizës në kushte normale të pages mendoj se do tu takonte:

Shuma prej 5.663.68 euro (52292.55 krona nervogjeze) dhe me shkronja pesëmijë e gjashtëqind e gjardhjetë e tri euro e gjardhjetë e tetë cent në emër të shpenzimeve të bëra sipas faturave të preznatuara dhe të konvertuara sipas tabelës numër 1 dhe 2, të cilës ekspertizë të ekspertit finaciari të kryer në mënyrë profesionale gjykata ja ka falë besimin

Për të vertetuar lartësin e kërkesë padisë, gjykata sipas propozimit të palëve,në cilësin e provave material ka nxjerrë ekspertizën e ekspertëve, nga Dr. Nazmi Morina Kirurg dhe Muhamet Halilaj, psikiatër, mjekë në Spitalin Regjional në Pejë, të dhënë në procesverbalin e shqyrtimit kresor të dates **27.07.2018**, të cilët e kanë dhënë mendimin e tyre professional drejt për drejt në procesverbalin e cekur më lartë, me çrast janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeveve dhe frikës që kanë pësuar paditësit si pasoj e këtij aksidenti.

Gjykata ka refuzuar kerkespada e paditësve V. K. N. K,j, M. K. dhe L. K. të gjitha nga fshati R., K-D. dhe M.O. nga K- D. si në piken **IV**të dispozitivit të ketij aktgjykimi, që të detyrohet e paditura B.K. e S. me seli në Prishtinë, dhe atë:

Për paditsen V. K. në emer të demit jo material

Zhdemtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej—1800euro
Zhdemtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej -----1000 euro
Zhdemtim për dhimbje shpirtërore për shëmtim shumën prej-----2500 euro

Për demin material

Shpenzime për ushqim të përforëcur shumën prej-----250 euro
Shpenzime për kujdes dhe ndihmë të huaj në shumën prej-----250 euro
Shpenzimet për terapi fizikale Shumen prej -----800 euro

Për paditsen N. K. në emer të demit jo material

Zhdemtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej-----1500 euro
Zhdemtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej-----1000 euro
Zhdemtim për zvoglimin të aktivitetit të përhershem jetësor shumën prej----- 1500 euro

Për paditsen M. K.në emer të demit jo material

Zhdemtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumën prej---1000 euro
Zhdemtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumën prej-----500 euro

Për paditsen M. O. në emer të demit jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike-trupore për të gjitha llojet, shumë prej---1500 euro
Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet shumë prej-----1000 euro
Zhdëmtim për zvoglimin të aktivitetit të përhershëm jetësor shumë prej-----1500 euro

Për pjesën e kërkesës së refuzuar si në pikën **IV**, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, që lidhet me dëmin jo material dhe material gjykata vendosi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e cënuar të padiseve dhe me qëllim që kompensimi të jetë i drejtë.

Në rastin konkretë me provat e administruar nga gjykata sipas propozimeve të palëve, palëve paditëse nuk mundën ta argumentojnë kërkesën e tyre për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë.

Për lartësin e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e demit jo material dhe material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 par .1 të ligjit Nr 04/L-077 për mardhenje e detyrimeve e lidhur me nenin 323 të LPK-së, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësin e të miës së shkelur dhe qëllimin për të cilin shërben kompensimi i gjykura, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të demturit.

Gjykata pasi vertetoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh dhimbjet e përjetuar fizike intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve, intensitetin dhe shkallën e frikës, duke marrë për bazë edhe rrethanat e tjera që ndikojnë në percaktimin e lartësisë së kompensimit dhe praktikën gjyqësore vendosi sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në tërësi i ka pranuar konstatimet e ekspertëve në fjalë, se të njejtat janë dhëne nga ana e ekspertëve përkatës dhe përputhen mes veti dhe dokumentacionin mjekësor që gjindet në shkresat e lëndës.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vertetuar faktike si më lartë e ka aprovuar pjesërisht kërkespadin e paditesve si ne piken **I** dhe **II** të dispozitivit të ketij aktgjykimit si të bazuar, duke vlersuar se e paditura mbanë përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar paditrësve me rastin e lëndimeve në aksident të trafikut për çka e paditura është e obliguar që ta kompensoi dëmin mbi bazën e auto përgjegjësis, në kuptim të dispozitave të nenit 136,140,159,179 dhe 183 të LMD-së.

Vendimin që e paditura paditësve tija shpërblej shpenzimet e procedurës kontesti morë, gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 449 par.1,2 ,452 dhe 463 par. 2 të LPK-së, sepse paditëset si gjyq fituese, i takon e drejta në shpërblimin e shpenzimeve të procedurës më kusht që i njëjtat këto shpenzime i autorizuari i paditësve av. Bajarm Mujaj ti ketë specifikuar, sipas të Tarifës së Odes se Avokatëve të Kosovës dhe atë për përpilimin e padisë për 5 paditës në shumë 624.00 euro , për taksë për padi 20.00 euro, për përpilimin e parashtrësës mbi precizimin e padisë për 5 paditës shumë 624.00 euro, për dhenjen e mendimit te ekspertit te Psikatris ne shumen prej 250.00 euro , për dhenjen e mendimit te ekspertit te Ortopedis ne shumen prej 301.00 euro, për pagesë e ekspertizes të eksperit Financiar 100.00 euro, për 6 seanca të mbajtura për 5 (pesë) paditës në shum prej 811.20 euro, për dy séance të shtyra 405.60 euro të gjitha keto në shum të përgjithshem prej 3.135.80 euro.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar me ankesë edhe pse nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, pika n) të pretenduara nga pala ankuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, me përjashtim të vendosjes lidhur me shpenzimet e procedurës, dhe në këtë pikë aktgjykimi i ankimuar u ndryshua pjesërisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve ankimore të të paditurës, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), ngase nga nga përmbajtja dhe struktura e aktgjykimit të ankimuar, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka harmonizuar në tërësi përmbajtjen si në pikën **I** dhe **II**, të dispozitivit dhe se e njëjta ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare të cilat kanë rezultuar me aprovimin e kërkesëpadisë si në pikat e atakuara me ankesë, prandaj, ky pretendim ankimor rezulton i pa bazuar.

Të pa bazuara, refuzohen edhe pretendimet e palës së paditur në ankesën e ushtruar lidhur me lartësinë e kompensimit të gjykuar si për dëmin material ashtu edhe jo material si në pikën **I** dhe të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, ngase nga shkresat e lëndës rrjedh se gjykata e shkallës së parë përderisa mes palëve ndërgjyqëse baza juridike pjesërisht ka qenë jo kontestuese me përjashtim të kompensimit të shpenzimeve të shërimit të cilat pala e paditur i ka kontestuar, nga administrimi i provave nga gjykata e shkallës së parë sa i përket kategorisë së dëmit material dhe jo material, gjykata e shkallës së parë, në përputhje me nenin 136, 137, 179 dhe 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 094/L-077, në lidhje me nenin 18 par.1,2 dhe 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-118, si dhe në harmoni të plotë edhe me Udhëzuesin Juridik të Miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 41/23, dt: 27.02.2023, për kriteret orientuese të zbatuara në caktimin e lartësisë së kompensimit të dëmit material dhe jo material , drejtë ka gjykuar shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, dhe se këto shuma janë në koheherencë me natyrën, kohëzgjatjen dhe intensitetin e pasojave të përjetuara nga paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të të paditurës lidhur me shpenzimet e shërimit të paditësve në Norvegji ku të njëjtit kanë marrë trajtim mjekësor pas aksidentit, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar shumën totale të gjykuar prej 5,663.18 euro, e cila shumë ka derivuar sipas ekspertizës financiare nga shuma e shpenzuar në emër të shpenzimeve të shërimit nga paditësit në Norvegji në 52,292.55 KRuna Norvegjeze, të cilat nga konvertimi i bërë sipas kursit valutor në kohën e ekspertizës financiare kanë rezultuar se shuma totale e shpenzuar nga paditësit për shërimin e pasojave nga aksidenti i komunikacionit i datës 26.07.2015 në fshatin Carrabreg/Komuna e Deçanit, është 5,663.18 euro, e cila shumë është dokumentuar edhe me fatura të prezantuara nga paditësit dhe dokumentacion mjekësor të shoqëruar nga Klinika në Norvegji e të cilat raporte mjekësore dhe fatura të prezantuara kanë rezultuar të vërteta dhe reale, e gjithashtu në shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësit nuk janë mbuluar nga sigurimi shëndetësor Norvegjez për këto lëndime të pësuar, ashtu që, kjo

shumë e të hollave duhet t'iu paguhet paditësve, në kuptim të nenit 177 par.2 të LMD-së, ashtu që, pretendimet ankimore të të paditurës se këto shpenzime nuk është vërtetuar përmes ekspertit se kanë qenë të domosdoshme për shërimin e paditësve, ngase këto shpenzime janë shkaktuar nga paditësit me qëllim të shërimit të tyre, dhe kjo është vërtetuar përmes dokumentimit të tyre të lëshuara nga klinikat përkatëse, ashtu që, me vërtetimin e këtyre fakteve, drejtë është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykatës së Apelit, i rezultuan të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me shpenzimet e procedurës, ashtu që, në këtë pikë referuar nenit 465 par.2 të LPK-së, duke marrë për bazë shpenzimet e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë vlerësoi se shumica e gjykuar në aktgjykimin e ankimuar dhe aktvendimin e përmirësuar nga i cili ka rezultuar shumica totale e shpenzimeve prej ,956.40 euro, kjo gjykatë gjeti se në bazë të shkresave të lëndës, gjykata e shkallës së parë ia ka njohur palës paditëse si kompensim edhe parashtresën për zgjerimin e padisë e cila nuk hyn si parashtresë për të cilën kompensohet i autorizuari i palës paditëse, e gjithashtu edhe për dy seanca gjyqësore të shtyera me kërkesën e palës paditëse dhe një seancë të shtyer për arsye të gjykatës dhe këto shpenzime procedurale nuk i takojnë si kompensim palës paditëse nga e paditura ngase nuk janë shkaktuar me fajin e saj, prandaj, mbi bazën e këtyre arsyeve, gjykata e shkallës së dytë, aktgjykimin e ankimuar në pjesën e shpenzimeve të procedurës e ndryshoi pjesërisht duke gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, dt: 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e ushtrimit të padisë për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë, ndërsa për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar duke pasë për bazë interesin juridik të parashtruesit të ankesës nuk është atakuar në pikën IV të dispozitivit të tij (pjesën refuzuese të kërkesëpadisë), duke marrë për bazë edhe institutin “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-së, atëherë gjykata e shkallës së dytë, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe e) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 6533/21, data 20.05.2024

Numri i lëndës: 2019:135328
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05751066

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka**